



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KUVENDI

Komisioni per Çeshtjet Kushtetuese dhe Ligjore

R E L A C I O N

Per “Dekretin nr. 3065.date 18. 06. 2001 “Per kthimin e ligjit r. 8813, date 17.05.2001 “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7905,date 21. 03. 1995 Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise”

Komisioni i Ligjeve, ne mbledhjet e datave 14 shtator, 17e 23 tetor 2001, (dhe pasi e rinjohu relacionin me anetaret e opozites ne mbledhjen e komisionit me 30 maj 2002) mori në shqyrtim “Dekretin nr. 3065.date 18. 06. 2001 “Per kthimin e ligjit nr. 8813, date 17.05.2001 “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7905,date 21. 03. 1995 Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise”

Presidenti i Republikes ka kthyer ligjin nr. 8813, date 17.05.2001, “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7905,date 21. 03. 1995 Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise”.

Ne motivimin e kthimit Presidenti i Republikes ben keto verejtje:

1.Ne ligjin nr. 8813, date 17.05.2001, “Per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7905,date 21. 03. 1995 Kodi i Procedures Penale i Republikes se Shqiperise” eshte parashikuar suprimimi i Gjykates Ushtarake te Shkalles se Pare e Gjykates se Apelit, nje gje e tille sugjeron Presidenti duhet te rregullohet nepermjet ligjit organik “Per Organizimin e funksionimin pushtetit gjygesor”, pasi ne baze te ketij ligji keto gjykata jane ne perberje te sistemit gjygesor .Heqja e kompetences lendore te ketyre gjykatave nga ligji procedural penal duhet te shoqerohej detyrimisht dhe me suprimimin e tyre me ndryshimet perkatese ne ligjin organik. Ligji procedural nuk eshte ligji qe krijon apo shperben gjykata, por ai percakton kompetencat e tyre.

Suprimimi i Gjykatave Ushtarake kerkon nje analize te plote dhe egzistenca ose jo e tyre duhet te gjeje konfirmimin vetem ne ligjin “Per organizimin e funksionimin e pushtetit gjygesor ne Republikën e Shqiperise”.

14

2. Ka konfuzion ne formulimin e nenit 75/a persa i perket juridiksionit fillestar ne Gjykatën e Lartë, nderkohe qe ne nenin 147/1 te Kushtetutes. Ne ligj duhet te pasqyrohet qarte e jo te nenkuptohet juridiksioni fillestar e perberja e trupes gjyqesore se Gjykates se Larte.

3. Ligji duhet te rregullonte dhe ceshtjen nese vendimi i Kolegjit Penal te Gjykates se Larte eshte vendim perfundimtar e formes se prere.

Komisioni i Ligjeve pasi shqyrtoi verejtjet e Presidentit dhe pasi i ballafaqoi me Specialistet e Ministrise se Drejtesise i konsideron ato te drejta e te sakta duke i pranuar ato teresisht **dhe i propozon seances ndrshimet perkatese, te cilat propozohen te jene sa me poshte ne ligj.**

- **Ne nenin 1**

Ne piken 1 te nenit 13 qe ndryshohet, pas fjaleve “ te renda”, te shtohen fjaltet “ gjykatat ushtarake”

- **Neni 2 i projektit, riformulohet si vijon :**

“ Neni 14

Gjykatat e apelit dhe perberja e tyre

1. “Gjykatat civile te apelit shqyrtojne ne shkalle te pare, me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare, ceshtjet e gjykuara nga gjykatat e rretheve gjyqesore”.

2. Gjykata ushtarake e apelit shqyrton ne shkalle te dyte, me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare, ceshtjet e gjykuara nga gjykatat ushtarake.”

3. Seksioni perkates i Gjykates se Apelit Tirane shqyrton ne shkalle te dyte, me trup gjykues te perbere nga pese gjyqtare, ceshtjet e gjykuara nga gjykata e krimeve te renda. “

- **Ne nenin 3**

Ne nenin 14/a te shtuar, fjaltet “me pjesemarrjen e te gjithe gjyqtareve”, te hiqen.

15

- Ne nenin 4

Paragrafi i pare i nenit 21 qe ndryshohet, te riformulohet si vijon :

“Kerkesa per perjashtimin e gjyqtareve shqyrtohet ne seance nga nje gjyqtar tjeter i se njejtës gjykate. Ndaj vendimit per pranimin ose rrezimine kerkeses per perjashtim lejohet ankim se bashku me vendimin perfundimtar te ceshtjes.”

- Neni 8, te hiqet

- Ne nenin 12 te riformulohet si vijon :

“Neni 74 ndryshohet si vijon :

“Neni 74

Kompetencat e gjykates se rrethit gjyqesor

Gjykata e rrethit gjyqesor eshte kompetente per gjykimin e veprave penale, pervec atyre qe i perkasin kompetences se gjykates se krimeve te renda, gjykates ushtarake dhe Gjykates se Larte.”

- Pas nenit 12 te projektit te shtohet nje nen tjeter me kete permbajtje :

“Neni 12/1

Neni 75 ndryshohet si vijon :

“Gjykata ushtarake eshte kompetente per gjykimin e ushtarakeve, roberve te luftes dhe personave te tjere, per veprat penale te parashikuara nga Kodi Penal Ushtarak dhe dispozita te tjera ligjore, pervec atyre qe i perkasin kompetences se gjykates se krimeve te renda dhe Gjykates se Larte.”

- **Neni 13 i projektit, riformulohet si vijon :**

“ Neni 13

Pas nenit 75, te shtohet neni 75/a, me kete permbajtje :

“Neni 75/a

Kompetencat e gjykates se krimeve te renda

Gjykata e krimeve te renda gjykon krimin e krijimit te bandes se armatosur dhe te organizates kriminale, krimet e kryera prej tyre, cdo krim qe denohet ne minimum jo me pak se 15 vjet burgim, si dhe krimet e parashikuara nga nenet 140 dhe 284/a te Kodit Penal, duke perfshire edhe rastet kur ato jane kryer nga subjekte qe jane ne kompetence te gjykatave ushtarake dhe te miturit. “

- **Ne nenin 14, te riformulohet si vijon :**

“Pas nenit 75/a, te shtohet neni 75/b me kete permbajtje :

“Neni 75/b

1. Gjykata e Larte shqyrton rekurset per shkelje te ligjit dhe kerkesat per rishikimin e vendimeve te formes se prere.

VARIANTI 1

2. Gjykata e Larte gjykon ne shkalle te pare me trup gjykues te perbere nga 5 gjyqtare te caktuar me short, veprat penale te kryera nga Presidenti i Republikes, deputetet, Kryeministri dhe anetaret e Keshillit te Ministrave, gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese dhe gjyqtaret e Gjykates se Larte, kur ata jane ne keto funksione ne kohen e gjykimit.

VARIANTI 2

2. Gjykata e Larte gjykon ne shkallë te pare me kolegje te bashkuara, veprat penale te kryera nga Presidenti i Republikes, deputetet, Kryeministri dhe anetaret e Keshillit te Ministrave, gjyqtaret e Gjykates Kushtetuese dhe gjyqtaret e Gjykates se Larte, kur ata jane ne keto funksione ne kohen e gjykimit.

3. Gjykimi i percaktuar ne piken 2 te ketij neni, zhvillohet duke respektuar per aq sa nuk vijne ne kundërshtim, rregullat e gjykimit ne

14

shkalle te pare. Vendimi i shpallur nga kjo gjykate eshte i formes se prere.”

- **Ne nenin 27**

Numertimi “224” te zevendesoshet me “244”.

Ne nenin 32, pika 2 e tij ndryshohet si vijon :

2. Pika 3 ndryshohet si vijon :

3. Kur del se arrestimi a ndalimi jane bere ne menyre te ligjshme gjykata merr vendim per vleftesimin e mases. Kunder vendimit te gjykates mund te behet apel ne gjykatën me te larte nga prokurori dhe i arrestuari ose i ndaluari dhe, kur ka kerkese nga prokurori, cakton masen e sigurimit.”

- **Neni 50 i projektit te ndryshohet si vijon :**

“ Ne nenin 410, ne piken 2, pas fjales “leshuar”, shtohen fjalet “nga i pandehuri”.

- **Neni 51 i projektit ndryshohet si vijon :**

“Ne nenin 424, pas pikes 2 te shtohet nje pike 3 me kete permbajtje : Mbi ankimin e bere kunder vendimeve te gjykates se krimeve te renda vendos Gjykata e Apelit Tirane.

Neni 52 i projektit, ndryshohet si vijon :

“Neni 431, ndryshohet si vijon :

“Neni 431

Rekurs i drejtperdrejte ne Gjykatën e Larte

Jane objekt rekursi te drejtperdrejte ne Gjykatën e Larte vendimet e gjykates per mosmarreshjet lidhur me juridiksionin dhe kompetencat, si dhe rastet e vecanta te parashikuara me ligj. “

Pas nenit 63, te shtohet nje nen me kete permbajtje :

“Ne nenin 514, ne piken 1, shkronja “e” te shfuqizohet.

KRYETAR

Spartak BRAHO

